



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
UJËSJELLËS KANALIZIME MALËSI E MADHE SH.A  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 1908/Prot.  
1

Koplik, me: 22.08.2023

Vendim

Nr. 04 datë 02/08/2023.

**PËR**  
**“MIRATIMIN E PRISHJES SË SHOQËRISË, FILLIMIN E PROCEDURËS SË**  
**LIKUIDIMIT DHE CAKTIMIN E LIKUIDUESIT TË UJËSJELLËS KANALIZIME**  
**MALËSI E MADHE SH.A”**

Në mbështetje të ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar; të Statutit të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Malësi e Madhe sh.a; të Kreut II, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.302 datë 11.05.2022 “Politikat Kombetare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me uje dhe largimit, trajtimit e përpunimit të ujrave të ndotura; të marrëveshjes date 19.01.2023 “Marrëveshje për Krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizime” ndërmjet Bashkisë Malësi e Madhe , Bashkisë Vau Dejes, Bashkisë Pukë, Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; të Vendimit të Këshillit Bashkia Malësi e Madhe Nr.24 datë 24.03.2023 si dhe në marrëveshjen date 16.05.2023 “Marrëveshjen e Bashkëpunimit Për Transferim Aktiviteti” ndërmjet Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkoder sh.a me Nipt: M378197010 dhe shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Malësi e Madhe sh.a me Nipt; K48420718C, duke qene para faktit që shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Malësi e Madhe sh.a e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi nga data 30.06.2023 dhe kjo shoqëri nuk ka më të drejta të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar, nuk ka arsye të vijoje ekzistencën e saj Asambleja e Përgjithshme :

**VENDOSI:**

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj. Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.
2. Largimin nga detyra të administratorit Z.Ndoc Prela dhe emerimin z.Ndoc Prela me ID: G80210189U Likuidator i Shoqërisë.
3. Paga bruto e likuidatorit të shoqërisë është 80.000 lekë
4. Autorizohet Likuidatori i Shoqërisë të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin shoqërisë.



5. Autorizohet Likuidatori i Shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore në QKB.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

**TONIN MARINAJ**

